



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 123

Tiranë – E mërkurë, 6 korrik 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 29.6.2016	Për lirim dhe emërim në detyrën e anëtarit të Këshillit të Statistikave..... 8419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 29.6.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 8419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 29.6.2016	Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Shëndetësisë, për drejtoritë e spitaleve rajonale, Elbasan dhe Korçë..... 8419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 29.6.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 1128, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”..... 8424
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 484, datë 29.6.2016	Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me asbestin në vendin e punës..... 8424
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 29.6.2016	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Luzhiana Abazaj..... 8431
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 29.6.2016	Për klasifikimin e produkteve biocide..... 8431
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 491, datë 29.6.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lezhë–Shëngjin” (shtesa)..... 8435
	Ndreqje gabimi material në tekstin e vendimit nr. 399, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 99/2016.... 8436

**VENDIM****Nr. 478, datë 29.6.2016**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRËN E ANËTARIT TË KËSHILLIT
TË STATISTIKAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Diana Shtylla, anëtar i Këshillit të Statistikave, përfaqësues i Bankës së Shqipërisë, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Rudina Lilaj emërohet në detyrën e anëtarit të Këshillit të Statistikave, përfaqësues i Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 479, datë 29.6.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në

listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”.

1. FARID; AIDER.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM**Nr. 480, datë 29.6.2016**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
PJESSHME TË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, PËR
DREJTORITË E SPITALEVE RAJONALE,
ELBASAN DHE KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së



Shëndetësisë, për drejtoritë e spitaleve rajonale, Elbasan dhe Korçë.

Lista me 3 (tri) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i

Pasurive të Paluajtmshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE VECANTA)

Institucioni i Pushtetit Qendror : Ministria e Shendetesise					Identifikoi QENDRA SPITALORE "XHAFFERR KONGOLI"					
Bashkia Elbasan					Supervizori : Topo-Gjeodet HYSNI BAHITI					
Miratol <i>Alfred Capri</i>					Ing.FERDINAND SARACI					
					Fusha e perdorimit te prones :Shendetesi					
Nr.	A		Lloji i Prones	Emri i prones	Siperfaqja totale e prones shesh+objekt m2	Siperfaqja vetern e objektit (m2)	Numri i kateve shoqeruar me siperfaqen e cdo kati (m2)	Institucioni perdorues. Statusi juridik i perdorimit	Institucioni me pergjegjesi administrative	Shenime te vçanta
	Zona kadastrale & indeksi i hartes	Nr pasurit								
1	8525:EL:1-8	7/23	Truall+Objekt	PATHOLOGJIA	4579	4018	BODRUMI- 1216 KATI PARE 1400 KATI DYTE 1400	Qendra spitalore "Xhafferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	Shesh 563 Truall nen objekt 1400
2	8525:EL:1-8	7/25	Truall+Objekt	FARMACI + DIALIZA	389	332	KATI PARE 162 KATI DYTE 170	Qendra spitalore "Xhafferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	Shesh 57 Truall nen objekt 162
3	8525:EL:1-8		Truall+Objekt	MAGAZINE	172	116	KATI PARE 118	"	Ministria Shendetesise	Shesh -54,truall nen objekt 118
4	8525:EL:1-8	7/28	Truall+Objekt	GARAZHDE + OKSIGJENI	815	845	KATI PARE 645	"	Ministria Shendetesise	Shesh-170,truall nen objekt 645
5	8525:EL:1-8	7/33	Truall+Objekt	URGJENCA	2282.2	1152	KATI PARE 330.8 KATI DYTE 410.6 KATI DYTE 410.6	Qendra spitalore "Xhafferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	Shesh-1130.2 Truall nen objekt 330.8
6	8525:EL:1-8	7/29	Truall+Objekt	MORGU	567.8	450.8	KATI PARE 267 KATI DYTE 183.6	Qendra spitalore "Xhafferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	Shesh 117 Truall nen objekt 267
7	8525:EL:1-8	7/45	Truall+Objekt	LAVANTERIA+ GUZHINA	509	301.5	KATI PARE 301.5	"	Ministria Shendetesise	Shesh 207.5, truall nen objekt 301.5
8	8525:EL:1-8	7/32	Truall+Objekt	KABINE ELEKTRIKE	81	49	KATI PARE 49	"	Ministria Shendetesise	Shesh-22,truall nen objekt 49
9	8525:EL:1-8	7/46	Truall+Objekt	ADMINISTRATA	1564.8	833.8	KATI PARE 251 KATI DYTE 291.4 KATI TRETJE 291.4	Qendra spitalore "Xhafferr Kongoli"	Ministria e Shendetesise	Shesh 731 Truall nen objekt 251
10	8525:EL:1-8		Truall+Objekt	BLLOKU TEKNOLOGJIK	147	147	KATI PARE 147	"	Ministria Shendetesise	Truall nen objekt 147
11	8525:EL:1-8	7/41	Truall+Objekt	KIRURGJIA VJETER SKANERI E TELEMEDICINA	2807	2357	BODRUMI 114 KATI PARE 871 KATI DYTE 796 KATI TRETJE 576	Qendra spitalore "Xhafferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	KATI PARE 324 M2 DHE KATI I DYTE 220 41 RIKONSTRUKTUAR,PJESA TJETER JASHT FUNKSIONIT Shesh-450,truall nen objekt 871
12	8525:EL:1-8		Truall+Objekt	DHOME SHERBIMI	200	50	KATI PARE 50	"	Ministria Shendetesise	Shesh 150 , truall nen objekt 50


 FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
 (PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE VECANTA)

Institucioni i Pushtetit Qendror : Ministria e Shendetesise				Identifikoi QENDRA SPITALORE "XHAFERR KONGOLI"							
Bashkia Elbasan				Supervizori : Topo-Gjeodet HYSNI BAHITI							
Miratoi <i>Alfred Çakeri</i>				Ing.FERDINAND SARACI							
				Fusha e perdorimit te prones :Shendetesi							
Nr.	A		B		Siperfaqja totale e prones shesh+objekt m2	Siperfaqja vetem e objektit (m2)	Numri i kateve shqeruar me siperfaqen e cdo kati (m2)	Institucioni perdorues. Statusi juridik i perdorimit	Institucioni me pergjegjesi administrative	Shenime te vecanta	
	Zona kadastrale & Inceksi i hartes	Nr pasurii	Lloji i Prones	Emri i prones, adresa							
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
13	8525.EL.I-8	7/47	Truall+Objekt	PEDIATRIA	5772	4600	KATI PARE 920 KATI DYTE 920 KATI TRETJE 920 KATI KATER 920 KATI PESTE 920	Qendra spitalore "Xhaferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	KATI PESTE 920 JASHE FUNKSIONIT PJESA TJETER NE FUNKSION Shesh-1172, Truall nen objekt 920	
14	8525.EL.I-8		Truall+Objekt	TYNELI URGJENCE-PATHOLOGJI	338	338	KATI PARE 338	"	Ministria Shendetesise	Truall nen objekt 338	
15	8525.EL.I-8	7/49	Truall+Objekt	GODINAE DJEGIES SE MBETJEVE	197	159	KATI PARE 159	"	Ministria Shendetesise	Jashte funksionit. Shesh 38	
16	8525.EL.I-8		Truall+Objekt	VEND ROJE (PEDIATRI)	50	20	KATI PARE 20	"	Ministria Shendetesise	Shesh-30, truall nen objekt 20	
17	8525.EL.I-8		Truall+Objekt	KIRURGJIA E RE + MATERNITETI	4673.5	4269.5	BODRUMI 235.7 KATI PARE 1493 KATI DYTE 1493 KATI TRETJE 972 KATI KATERT 95.8	Qendra spitalore "Xhaferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	Shesh 384 Truall nen objekt 1493	
18	8525.EL.I-8		Truall+Objekt	MAGAZINE	51	26	KATI PARE 26	"	Ministria Shendetesise	Jashte funksionit. Shesh 25	
19	EL.I-9, M-9 8521	2/7	Truall+Objekt	POLIKLINIKA E SPECIALITETEVE	3799	2444	KATI PARE 998 KATI DYTE 815 KATI TRETJE 631	Qendra spitalore "Xhaferr Kongoli"	Ministria Shendetesise	Shesh 1355 Truall nen objekt 998	
Siperfaqe totale					28994.3	22328.5				Sip totale truall nen objekt 8548.3	
20	8525.EL.I-8, J-9		Rruge	RRUGE BRENDA TERRITORIT TE SPITALIT	7000			"	Ministria Shendetesise		
21	8525.EL.I-8, J-9		Sheshe	SHESHE TE PERGJITHSHME	16847			"	Ministria Shendetesise		
Siperfaqe totale					52841.3						



FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHMEKAE SHËNDETËSISË
(Për inventarizimin e pronave të vecanta)



Institucioni I pushtetit Qendror: Ministria e Shëndetësisë				Identifikoi: ARK KOÇO KALLANXHI						
Bashkia: Korçë				Supervizoi: DREJTORIA A SPITALIT RAJONAL Drejtor: PANDI PAPANDO						
Aprovoi: Ministria e Shëndetësisë				Fusha e përdorimit të pronës : Shëndetësi						
Nr.	A		Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	B		Nr. i kateve shoqëruar me sipërfaqen e çdo kati	C		
	Zonat Kadast& Indeksi I hartës	NR. Pasurisë			Sipërfaqja tot. e pronës (shesh + objekt)(m2)	Sipërfaqja vetëm e objektit (m2)		Institucion përdorues Statusi juridik I përdorimit	Institucioni me përgjegjësi administrative	SHENIME TE VECANTA
1	8562; KO-O-10 P-10	3/251	truall + ndërtesë	Spitali Rajonal Korçë, Shetitore "Fan Noli" L.4	7 367 m2 + 1531 m2	1 - Sipërfaqja e objektit te O.R.L. S= 295.8m2 2 - Sipërfaqja e Pediatrise S=658.3m2 3 - Sipërfaqja e Administrates S= 438.65 m2 4 - Sipërfaqja e Magazines = 117.8 m2 5 - Sipërfaqja e oksigjenit = 15m2	Kati P. Sip= 263.8m2 Kati 1 Sip= 295.8m2 Kati 2 Sip= 295.8m2 Kati 3 Sip= 295.8m2 Kati 4 Sip = 295.8m2 Podrum. Sip =658.3m2 Kati P. Sip =679.3m2 Kati 1 Sip =658.3m2 Kati 2 Sip =658.3m2 Kati 3 Sip =658.3m2 Kati P Sip = 438.65 m2 Kati 1 Sip = 438.65 m2 Kati 2 Sip = 438.65 m2 Kati P Sip =117.8 m2 Kati P Sip = 15 m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (O.R.L.) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (PEDIATRIA) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (ADMINISTRATA) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (MAGAZINA) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (DEPO OKSIGJENI)	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	
						1 - Sip. e KORPUSIT KRYESOR TE SPITALIT S=1842 m2 2 - Sip. e URGJENCES + AMBULANCES S= 1297 m2 3 - Sip. e FARMACI + BANKE GJAKU S= 205m2 4 - Sip. e GARDEROBES S=222m2	Kati P Sip =1842 m2 Kati 1 Sip =1842 m2 Kati P Sip = 1297 m2 Kati 1 Sip = 1297 m2 Kati P Sip = 205m2 Kati 1 Sip = 205m2 Kati P Sip =222m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (KORPUSI KRYESOR) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (URGJENCA DHE AMBULANCA) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (FARMACI + BANKE GJAKU) Drejtoria e Shërbimit Spitalor (GARDEROBA)		Te dyja mbikalime I përkasin katit të parë të Korpusit



2	8562; KO-O-10 P-10	3/250	truall + ndërtesë	Spitali Rajonalit Korce, Shërbimet "Fan Noli" L.4	1 939.0 m2 + 552.0 m2	5 - Sip. e KALDAJES S= 284m2	Kati P Sip = 284m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (KALDAJA)	SHËNDETËSISË
						6 - Sip. e MJEKUT LIGJOR S=175m2	Kati P Sip =175m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (MJEKU LIGJOR)	
						7 - Sip. e GARAZHEVE S=508 m2	Kati P Sip =508 m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (GARAZHE)	
						8 - Sip. e LAVANDERI S=139m2	Kati P Sip =139m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (LAVANDERI)	
						9 - Sip. e SENATORJUMIT S=741 m2	Kati P Sip =741 m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (SENATORJUMI)	
						10 - Sip. e OFICINES S = 75.6 m2	Kati P Sip =75.6m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (OFIÇINA)	
						11 + 12 - Sip. e VENDROJES 1+2 = 30 m2	Kati P Sip 1+2 = 30m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (VENDROJA)	
3	8564; KO-N-9	2/61	truall + ndërtesë	Materniteti, L. 7 Shëtitore " Fan Noli "	1 613 m2 + 747.2 m2	1--Sipërfaqja e GODINES SE MATERNITETIT Sip = 643.7m2	Kati P Sip =643.7m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (MATERNITETI)	MINISTRIA E SHËNDETËSISË
							Kati 1 Sip =643.7m2		
							Kati 2 Sip =643.7m2		
		2 - Siperfaqja e LAVANTERISE Sip = 103.5m2	Kati P Sip = 103.5m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (LAVANTERIA)					
4	8564; KO-N-9	2/1	truall + ndërtesë	Poliklinika, L. 7 Shëtitore " Fan Noli "	1 505.3 m2 + 723.6 m2	1 - Siperfaqja e Godines se POLIKLINIKES Sip. = 723.6 m2	Kati P Sip = 723.6 m2	Drejtoria e Shërbimit Spitalor (POLIKLINIKA)	MINISTRIA E SHËNDETËSISË
							Kati 1 Sip = 723.6 m2		
							Kati 2 Sip = 723.6 m2		

**VENDIM****Nr. 481, datë 29.6.2016****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 5.8.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MALLRAVE REZERVË MATERIALE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 6 e 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 1128, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Mallrat rezervë materiale shtetërore, që nuk financohen nga buxheti i shtetit, në çdo kohë transferohen pa pagesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit te subjektet shtetërore ose u shiten subjekteve private, sipas miratimit të organit, që ka këtë kompetencë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 484, datë 29.6.2016****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA RISQET LIDHUR ME ASBESTIN NË VENDIN E PUNËS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “c”, dhe 39, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave¹

¹ Ky vendim i Këshillit të Ministrave përafrohet plotësisht direktivën 2009/148/EC, të datës 30 nëntor 2009, Faqe| 8424

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me asbestin në vendin e punës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 2 (dy) vjet pas hyrjes në fuqi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE
NGA RISQET LIDHUR ME ASBESTIN NË
VENDIN E PUNËS**SEKSIONI I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit të punëmarrësve nga risqet që krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj asbestit në punë.

2. Kërkesat e kësaj rregulloreje zbatohen për ndërmarrjet, vendet e punës dhe veprimtaritë në të cilat punëmarrësit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen ndaj asbestit gjatë punës së tyre, duke përcaktuar vlerat e lejuara dhe kërkesa të tjera të veçanta.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të gjithë sektorët e veprimtarisë ku punëmarrësit janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit që përftohet nga asbesti apo nga materialet që përmbajnë asbest.

2. Veprimtari të tilla përfshijnë industrinë e nxjerrjes së asbestit, ndërtimin apo punimet ndërtimore dhe restaurimin, të tilla si: punime të

për mbrojtjen e punëmarrësve nga rreziku i ekspozimit ndaj asbestit gjatë punës, botuar në Fletoren Zyrtare OJ L330/28, 16.12.2009.



mirëmbajtjes së zakonshme, punime të mirëmbajtjes së jashtëzakonshme, punime rikonstruksioni, rindërtimi, punimet e kapsulimit apo heqjes së asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest në godina, mjetet motorike të transportit detar, hekurudhor, makineritë bujqësore dhe në veshjet e tyre, si dhe veprimtaritë për asgjësimin e mbetjeve.

3. Dispozitat e legjislacionit përkatës të shëndetit dhe të sigurisë në punë janë plotësisht të zbatueshme në të gjithë/a fushën/at e përmendur në pikën 2 të këtij neni, përveç rasteve kur ka një dispozitë më shtrënguese ose më specifike në këtë rregullore.

Neni 3

Përkufizime

Për efekt të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “asbest” përfshin silikatet fijore të mëposhtme:

- i) aktinolit, CAS nr. 77536-66-4;
- ii) gruenerite/amosit, CAS nr. 12172-73-5;
- iii) antofilit, CAS nr. 77536-67-5;
- iv) krisotil, CAS nr. 12001-29-5;
- v) krokidolit, CAS nr. 12001-28-4;
- vi) tremolit, CAS nr. 77536-68-6.

b) “veprimtari/punë me afat të shkurtër”, në lidhje me asbestin, përfshin çdo veprimtari për një periudhë prej 7 (shtatë) ditësh kalendrike:

- i) që nuk zgjat më shumë se dy orë pune;
- ii) ku punëmarrësi nuk përfshihet në më shumë se një orë pune.

c) “Autoritetet e inspektimit”, Inspektorati Shtetëror i Punës, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, autoritetet e inspektimit të ndërtimit;

ç) “Autoriteti kompetent”, organet kompetente të hetimit dhe të drejtësisë.

SEKSIONI II

DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 4

Vlerësimi i riskut

1. Punëdhënësi, në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, siguron vlerësimin e risqeve në veprimtaritë që mund të shfaqin risk të

ekspozimit ndaj pluhurit të asbestit ose të materialeve që përmbajnë asbest, ndaj të cilit janë të ekspozuar punëmarrësit.

2. Vlerësimi i riskut duhet të përfshijë:

a) tipin e asbestit ndaj të cilit punëmarrësit mund të ekspozohen;

b) natyrën dhe shkallën e ekspozimit ndaj asbestit që mund të shfaqet gjatë punës;

c) rezultatet e monitorimit të ekspozimit ndaj asbestit, në përputhje me paragrafin 3, të nenit 8, të kësaj rregulloreje;

ç) masat parandaluese ndaj ekspozimit ose uljen e nivelit të pranisë së asbestit më pak se vlera kufi e lejuar, në ajrin e zonës së punës;

d) rezultatet e kontrollit periodik të shëndetit në punë;

dh) çdo informacion tjetër të vlefshëm që i nevojitet punëdhënësit për të plotësuar vlerësimin e riskut.

3. Në kushtet kur ekspozimi i punëmarrësit është i rastësishëm dhe me intensitet të ulët ose shkalla e ekspozimit të punëmarrësit ndaj asbestit është e ulët dhe kur nga vlerësimi i riskut rezulton se vlera kufi të lejuara për asbestin nuk do të tejkalohet në ajrin e zonës ku punohet, dispozitat e neneve 5 dhe 15, të kësaj rregulloreje, mund të mos zbatohen në rastet kur puna përfshin:

a) veprimtari të shkurtra, jo të vazhdueshme restaurimi, në të cilat përdoren materiale jofijore;

b) heqje, pa shkatërrim, të materialeve të padëmtuara, në të cilat fijet e asbestit janë pazgjidhshmërisht të lidhura;

c) kapsulim ose mbyllje të materialeve që përmbajnë asbest dhe që janë në gjendje të mirë;

ç) kontroll dhe monitorim të ajrit dhe mbledhje e mostrave për të vlerësuar nëse materiali në fjalë përmban asbest.

4. Të dhënat nga vlerësimi dhe/ose matja e nivelit të ekspozimit ndaj asbestit ruhen në formë të përshtatshme, në godinën e ndërmarrjes, pas konsultimit me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre, për aq kohë sa vazhdon procesi i punës dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe duhet rishikuar kur ka arsye për të besuar se ai është i pasaktë ose ka një ndryshim material në punë.

5. Punëdhënësi rishikon vlerësimin e riskut:

a) rregullisht, çdo gjashtë muaj;

b) menjëherë, në qoftë se:



i) ka arsye të mjaftueshme për të dyshuar se vlerësimi i riskut nuk është i vlefshëm;

ii) ka ndryshim thelbësor në kushtet e punës për të cilën është kryer vlerësimi i riskut;

iii) rezultatet e monitorimit të ajrit, të kryera, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje, tregojnë që është i nevojshëm.

6. Punëdhënësi ndryshon vlerësimin e riskut kur:

a) ka arsye për të besuar se nuk është i saktë;

b) ka ndryshim në kushtet e punës;

c) nga rishikimi, del nevoja për ndryshim të vlerësimit të riskut.

7. Punëdhënësi kryen dhe regjistron ndryshimet sipas shkronjës “c”, të pikës 6, të këtij neni, në rastet kur ato janë rezultat i drejtpërdrejtë i gjetjeve dhe i përfundimeve të vlerësimit të riskut.

8. Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për mirëqenien sociale miratojnë udhëzimet praktike për përcaktimin e shkallës së ekspozimit ndaj asbestit në veprimtari të shkurtra dhe me intensitet të ulët, siç parashikohet në pikën 3 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, përkatëse, në fuqi, pas konsultimeve me përfaqësues të punëdhënësve dhe të punëmarrësve.

Neni 5

Sistemi i njoftimit

1. Punëdhënësi, në veprimtari të parashikuara në pikën 3, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, ndërmer të gjitha masat e parashikuara në pikat 2, 5 dhe 6, të nenit 4, të rregullores.

2. Veprimtari të parashikuara në pikën 3, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, do të mbulohen nga një sistem njoftimi tek autoritetet inspektuese.

3. Punëdhënësi, para fillimit të punimeve me prani të asbestit, njofton autoritetet inspektuese përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë kalendarike para fillimit të punimeve të licencuara me prani të asbestit.

Ky njoftim përfshin:

a) emrin e subjektit njoftues, adresën dhe numrin e telefonit/adresën elektronike të selisë së godinës qendrore ose të administratës së subjektit;

Faqe | 8426

b) përshkrimin e shkurtër, të:

i) vendndodhjes së zonës së punës;

ii) llojit dhe sasisë së asbestit të përdorur ose të trajtuar;

iii) veprimtari të dhe proceset që përfshihen;

iv) numrin e punëmarrësve të përfshirë;

v) masat e marra për të kufizuar ekspozimin e punëmarrësve ndaj asbestit;

c) datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e punës;

ç) çdo ndryshim tjetër nga të dhënat e njoftimit paraprak, duke përfshirë mbylljen e punimeve. Ky njoftim bëhet me shkrim dhe menjëherë.

4. Punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre duhet të kenë akses në dokumentet e njoftimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, lidhur me ndërmarrjen apo institucionin ku punojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Punëdhënësi dorëzon njoftim të ri në rastet kur konstatohet rritje e konsiderueshme e ekspozimit ndaj pluhurit të asbestit apo të materialeve që përmbajnë asbest.

Neni 6

Ndalimet

Me përjashtim të atyre aktiviteteve që lidhen me trajtimin dhe largimin e produkteve që rezultojnë nga shkatërrimi dhe largimi i asbestit, janë të ndaluara veprimtari të ekspozojnë punëmarrësit ndaj fijeve të asbestit, si më poshtë vijon:

a) përdorimi i asbestit me anë të procesit të spërkatjes;

b) proceset që përfshijnë përdorimin e izolimit me densitet të ulët (më pak se 1 g/cm³) ose të materialeve izolues (kufizues) ndaj zhurmave, të cilat përmbajnë asbest;

c) nxjerrja e asbestit;

ç) prodhimi dhe përpunimi i produkteve që përmbajnë asbest;

d) prodhimi dhe përpunimi i produkteve që përmbajnë asbest të shtuar në mënyrë të qëllimshme.

Neni 7

Parandalimi dhe zvogëlimi i ekspozimit ndaj asbestit

1. Punëdhënësi, për veprimtari të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të kësaj rregulloreje, siguron që ekspozimi i punëmarrësve ndaj



pluhurit të asbestit ose materialeve që përmbajnë asbest në vendin e punës:

a) të zvogëlohet sa më shumë të jetë e mundur praktikisht;

b) në rast të pamundësisë së parandalimit, të zvogëlohet, në çdo rast, nën nivelin e vlerës kufi të lejuar.

2. Punëdhënësi për të përmbushur kërkesat e pikës 1 të këtij neni, merr masat e mëposhtme:

a) kufizon në minimum numrin e punëmarrësve të ekspozuar ose në risk për ekspozim ndaj pluhurit të përftuar nga asbesti ose nga produktet që përmbajnë asbest në vendin e punës;

b) projektton ato procese pune që nuk prodhojnë pluhur asbesti dhe, kur kjo nuk është e mundur, shmang çlirimin e pluhurit të asbestit në ajër;

c) siguron pastrimin dhe mirëmbajtjen në mënyrë të vazhduar dhe efektive të të gjitha ambienteve dhe pajisjeve të punës, të përfshira në trajtimin e asbestit;

ç) siguron mbledhjen dhe heqjen me shpejtësi të mbetjeve të asbestit dhe materialeve që prodhojnë pluhur asbesti në ambalazhim të përshtatshëm, të mbyllur dhe të pajisur me etiketë për përmbajtjen e asbestit. Këto masa nuk do të zbatohen në veprimtaritë minerare. Në këtë rast, mbetjet do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar për mbetjet dhe specifikisht për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme;

d) në rastet kur vlera kufi e lejuar është tejkaluar, punëdhënësi:

i) njofton menjëherë punëmarrësit e përfshirë dhe përfaqësuesit e tyre;

ii) siguron ndërprerjen e punës në zonën e prekur, derisa të jenë marrë masat e përshtatshme për zvogëlimin e ekspozimit nën vlerën kufi të lejuar;

iii) identifikon me shpejtësi arsyet e tejkalimit të vlerës kufi;

iv) merr masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes dhe parandalimin e përsëritjes së saj në të ardhmen;

v) kontrollon menjëherë efektivitetin e masave të marra, nëpërmjet matjeve të pranishme të asbestit në ajër.

3. Materialet prej asbesti ose që gjenerojnë pluhur asbesti duhet të ruhen dhe të transpor-

tohen në ambalazhe të mbyllura dhe të përshtatshme.

Neni 8

Vlerat kufi dhe matja e përqendrimit të fijeve të asbestit

1. Punëdhënësi, në varësi të rezultateve të vlerësimit fillestar të riskut, për të siguruar ruajtjen e vlerës kufi të parashikuar në pikën 8 të këtij neni, kryen rregullisht matjen e fijeve të asbestit në ajër në zonën ku punohet.

2. Mostrat e marra për matjet duhet të përfaqësojnë shkallën e ekspozimit të punëmarrësve ndaj pluhurit të përftuar nga asbesti ose materialet që përmbajnë asbest.

3. Marrja e mostrave kryhet pas konsultimit me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje.

4. Marrja e mostrave kryhet nga personel i kualifikuar dhe sipas metodologjisë së përcaktuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.

5. Mostrat e marra do të analizohen, në përputhje me përcaktimet e pikës 6 të këtij neni, në laboratorë të certifikuar për matje të cilësisë së ajrit dhe të pajisur me aparatura për matje të fijeve të asbestit.

6. Kohëzgjatja e marrjes së mostrave do të jetë e tillë që ekspozimi i punëmarrësit të përzgjedhur të shtrihet në një periudhë tetëorëshe (një ndërresë), me anë të matjeve ose nëpërmjet llogaritjeve të ponderuara të kohës.

7. Për të matur asbestin në ajër, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, do të numërohen vetëm fijet me gjatësi më të madhe se 5 mikrometra, gjerësi më të vogël se 3 mikrometra dhe me një raport gjatësi/gjerësi më të madh se 3:1.

8. Punëdhënësi siguron që asnjë punëmarrës të mos jetë i ekspozuar ndaj përqendrimit të asbestit në ajër më të madh se vlera kufi e lejuar, 0.1 fibra për cm³, në një periudhë kohe prej 8 orësh të ponderuara (TWA).

9. Në rastet kur vlera kufi është tejkaluar, punëdhënësi:

a) njofton menjëherë punëmarrësit e përfshirë dhe përfaqësuesit e tyre;

b) siguron ndërprerjen e punës në zonën e prekur, derisa të jenë marrë masat e përshtatshme për zvogëlimin e ekspozimit nën vlerën kufi të lejuar;



c) identifikon me shpejtësi arsyet e tejkalimit të vlerës kufi;

ç) merr masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes dhe parandalon përsëritjen e saj në të ardhmen;

d) kontrollon menjëherë efektivitetin e masave të marra, nëpërmjet matjeve të pranisë së asbestit në ajër.

10. Punëmarrësit, në të gjitha rastet kur ekspozimi ndaj asbestit nuk mund të ulet nën vlerën kufi të lejuar, pavarësisht masave parandaluese të përdorura, veshin pajisje mbrojtëse individuale (PMI) dhe, kryesisht, PMI-ja për frymëmarrjen. PMI-të mbahen të veshura për aq kohë sa është domosdoshmërisht e nevojshme për çdo punëmarrës.

11. Punëdhënësi, gjatë periudhave të punës, të cilat kërkojnë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale, parashikon ndërprerje të punës, në varësi të kushteve fizike dhe klimatike. Këto ndërprerje vendosen në konsultim me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Identifikimi i pranisë së asbestit

1. Punëdhënësi, përpara fillimit të punimeve të shembjes, ndërtimit ose restaurimit:

a) merr informacionin e nevojshëm, lidhur me praninë e asbestit në ndërtesë, nga pronarët e ndërtesës;

b) merr masat e nevojshme për identifikimin e materialeve të dyshuara për përmbajtje asbesti.

2. Në çdo rast dyshimi për prani të asbestit në materialet e ndërtimit apo në ndërtesë zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 10

Pajisjet mbrojtëse individuale

1. Në rastin e aktiviteteve, të tilla si shembja, punimet e heqjes të asbestit dhe punimet e restaurimit apo mirëmbajtjes, kur parashikohet që vlerat kufi të lejuara të ekspozimit ndaj asbestit në ajrin e zonës së punës do të tejkalojnë, pavarësisht marrjes së masave teknike të parandalimit të përgjithshëm për uljen e përqendrimit të asbestit në ajër, punëdhënësi, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve të përfshirë në veprimtari të tilla pune, merr masat si më poshtë vijon:

a) pajis punëmarrësit me pajisje mbrojtëse personale të frymëmarrjes e të veshjes dhe sigurohet që punëdhënësi t'i ketë veshur ato;

b) vendos shenjat treguese që paralajmërojnë tejkalimin e vlerave kufi të lejuara të asbestit në ajër;

c) parandalon përhapjen e pluhurit të prodhuar nga asbesti ose materialet që përmbajnë asbest jashtë godinës ose vendit të punës.

2. Para fillimit të aktiviteteve në fjalë, punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre konsultohen për masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 11

Plani i punës

1. Punëdhënësi harton planin e punës përpara fillimit të punimeve me prani të asbestit, të tilla si punimet e shembjes apo të heqjes së asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest nga ndërtesat për përdorim publik, ndërtesat industriale, si dhe mjetet e transportit dhe të infrastrukturës bujqësore, industriale dhe komunale.

2. Plani i punës parashikon masat e nevojshme që duhet të ndërmerren për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në vendin e punës, në përputhje me përcaktimet e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Plani përfshin, kryesisht, këto masa:

a) heqjen e asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest përpara fillimit të punimeve të shembjes, me përjashtim të rastit kur kjo paraqet rrezik më të madh për punëmarrësit, krahasuar me rastin kur asbesti dhe/ose produktet që përmbajnë atë nuk do të hiqen;

b) kur është e nevojshme, pajisjen e punëmarrësve me pajisjet mbrojtëse individuale, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 10, të kësaj rregulloreje.

c) verifikimin, për mungesë të riskut, të ekspozimit të punëmarrësve ndaj asbestit në përfundim të punimeve të shembjes dhe heqjes së asbestit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

3. Plani i punës, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, me kërkesë të autoriteteve shtetërore të inspektimit, deklarohet përpara fillimit të punës së planifikuar dhe përfshin informacionin e mëposhtëm:

a) natyrën dhe kohëzgjatjen e parashikuar të punës;



b) vendin ku do të kryhen punimet;

c) metodat e përdorura, në rastet kur puna përfshin trajtimin manual të asbestit ose të materialeve që përmbajnë asbest;

ç) karakteristikat e pajisjeve që do të përdoren për:

i) mbrojtjen dhe dekontaminimin e punëmarrësve të përfshirë,

ii) mbrojtjen e personave të tjerë të pranishëm ose në afërsi të vendit të punës;

d) masat e ndërmarra nga punëdhënësi për të siguruar përmbushjen e detyrimeve dhe kërkesave për parandalimin dhe zvogëlimin e ekspozimit ndaj asbestit;

dh) masat e ndërmarra nga punëdhënësi për të siguruar përmbushjen e detyrimeve për pastrimin e ndërtesës apo ndërmarrjes, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 14, të kësaj rregulloreje.

4. Para fillimit për shkatërrimin dhe heqjen e asbestit, kompanitë duhet të paraqesin prova të aftësisë së tyre në këtë fushë. Provat do të përcaktohen në përputhje me ligjet dhe/ose praktikën kombëtare.

Neni 12

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi siguron formimin e duhur për të gjithë punëmarrësit, të cilët janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit që përmban asbest. Formimi kryhet rregullisht dhe pa kosto për punëmarrësit.

2. Informacioni që ofrohet gjatë formimit duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm për punëmarrësit.

3. Punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar që punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre të marrin informacionin e duhur, në lidhje me:

a) rreziqet e mundshme për shëndetin, nga ekspozimi ndaj pluhurit që përftohet nga asbesti apo nga materialet që përmbajnë asbest;

b) vlerën kufi të lejuar të përqendrimit të asbestit dhe nevojën për monitorim të ajrit përreth zonës së punës;

c) kërkesat për ruajtjen e higjienës, përfshirë nevojën për ndalimin e duhanpirjes;

ç) masat që merren në lidhje me veshjen në punë dhe përdorimin e pajisjeve dhe veshjeve të mbrojtjes personale;

d) masat e tjera të veçanta, që ndihmojnë në zvogëlimin e ekspozimit ndaj asbestit.

4. Punëdhënësi, përveç masave që parashikohen në pikën 3 të këtij neni, ndërmerri masa shtesë, të përshtatshme për të siguruar që punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje:

a) të kenë akses në rezultatet e matjeve të përqendrimit të asbestit në ajër;

b) të marrin shpjegime në lidhje me ndikimin në shëndet të rezultateve të matjeve të përqendrimit të asbestit në ajër;

c) të informohen sa më shpejt, kur rezultatet tregojnë tejkallim të vlerës kufi të lejuar dhe arsyet që e shkaktuan;

ç) të informohen për masat që do të ndërmerren dhe/ose, në rast emergjence, të informohen për masat që janë ndërmarrë.

5. Formimi duhet t'u mundësojë punëma-rrësve fitimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme në drejtim të sigurisë në punë dhe parandalimit të ekspozimit ndaj asbestit, veçanërisht për sa u përket:

a) veçorive të asbestit dhe ndikimin e tij mbi shëndetin e njeriut, duke përfshirë edhe ndikimin e shumëfishuar në rastin e pirjes së duhanit;

b) llojeve të produkteve ose materialeve që mund të përmbajnë asbest;

c) veprimtarive që mund të sjellin ekspozim ndaj asbestit dhe rëndësinë e kontrolleve parandaluese për të zvogëluar ekspozimin;

ç) praktikave të sigurta të punës, kontrolleve dhe masave të mbrojtjes kolektive e personale, përdorimin e përshtatshëm, zgjedhjen e funksionimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse personale dhe, veçanërisht, pajisjeve mbrojtëse të frymëmarrjes;

d) procedurave të emergjencës;

dh) procedurave të dekontaminimit;

e) asgjësimit të mbetjeve;

ë) kërkesave për mbikëqyrjen shëndetësore.

Neni 13

Masat për menaxhimin e aksidenteve dhe incidenteve

1. Punëdhënësi, në veprimtaritë e para-shikuara në nenin 2 të kësaj rregulloreje, ndërmerri masa për të siguruar, që:

a) vendi ku kryhen veprimtari, të tilla:

i) të jetë i rrethuar dhe i dallueshëm nga tabela paralajmëruese;



ii) të lejohet hyrja vetëm për personat, të cilët, për shkak të punës së tyre apo detyrave, janë të detyruar të hyjnë në të;

iii) të ndalohet rreptësisht pirja e duhanit;

b) të jenë të përcaktuara vendet ku punëmarrësit mund të konsumojnë lëngje dhe ushqim pa u rrezikuar nga ndotja me pluhur asbesti;

c) veshjet e punës të qëndrojnë brenda ndërmarrjes. Në rast se dezinfektimi i tyre brenda ndërmarrjes është i pamundur, ato mund të dërgohen për t'u dezinfektuar në vende të posaçme, jashtë saj. Në këtë rast veshjet do të transportohen, sipas ligjit nr. 118/2012, "Për transportin e mallrave të rrezikshme";

ç) të jenë të përcaktuara vendet e ruajtjes së veshjeve të punës dhe të pajisjeve mbrojtëse personale, si dhe vend i posaçëm për veshjet individuale të punëmarrësve;

d) të ketë pajisje të përshtatshme hidro-sanitare, duke përfshirë edhe dushet, në rastet e veprimtarive me ekspozim ndaj pluhurit të asbestit;

dh) të ketë vend të posaçëm për pajisjet mbrojtëse personale, duke i kontrolluar dhe pastruar pas çdo përdorimi dhe duke marrë masa për të riparuar ose zëvendësuar pajisjet e dëmtuara para përdorimit pasardhës.

2. Ngarkohet punëdhënësi për të gjitha kostot e masave të marra të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 14

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Punëdhënësi organizon mbikëqyrjen shëndetësore, të përshtatshme për punëmarrësit, përpara fillimit të punës me ekspozim ndaj pluhurit të asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest, si dhe në intervale të rregullta kohore, për sa kohë zgjat ekspozimi ndaj asbestit në vendin e punës.

2. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të punëmarrësit përfshin një ekzaminim radiologjik/imazherik të kraharorit.

3. Vlerësimi radiologjik/imazherik i kraharorit kryhet, të paktën, çdo 3 (tre) vjet, për sa kohë zgjat ekspozimi ndaj pluhurit të asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest në vendin e punës. Bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën për sistemin e mbikëqyrjes

shëndetësore, aplikohen masat mbrojtëse dhe parandaluese në vendin specifik të punës. Këto masa mund të përfshijnë, kur është e përshtatshme, tërheqjen e punëmarrësit në fjalë nga të gjitha ekspozimet ndaj asbestit.

4. Për secilin punëmarrës, që i nënshtrohet mbikëqyrjes shëndetësore, mbahen e përditësohen të dhënat individuale të shëndetit dhe treguesit e ekspozimit në kartelën individuale të shëndetit në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë. Punëmarrësi, me kërkesën e tij, ka akses për të dhënat në dokumentin e shëndetit në punë dhe shkallën e ekspozimit. Kopje e dokumentit të shëndetit në punë i dorëzohen autoritetit kompetent, me kërkesë të tij.

5. Detajet për mbajtjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave shëndetësore e të dhënave të ekspozimit janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Të dhënat për shëndetin dhe ekspozimin e punëmarrësit ruhen në mënyrë të përshtatshme, që të jetë i mundur konsultimi dhe aksesimi nga ana e punëmarrësve, bazuar në parimin e konfidencialitetit. Të dhënat ruhen për një afat deri 40 vjet, pas përfundimit të ekspozimit. Kur ndërmarrja pushon veprimtarinë, lista e punëmarrësve të ekspozuar ndaj asbestit dhe dokumentet e shëndetit në punë dorëzohen pranë strukturave rajonale të shëndetit publik, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare në fuqi.

6. Kur, si rezultat i mbikëqyrjes shëndetësore, të kryer nga një mjek ose një profesionist i kujdesit shëndetësor në punë, një punëmarrës konstatohet me një sëmundje të identifikueshme ose efekt negativ për shëndetin, si pasojë e ekspozimit në punë ndaj asbestit, punëmarrësi informohet nga mjeku i punës ose persona të tjerë të kualifikuar, në mënyrë të përshtatshme, për rezultatin që lidhet me atë personalisht, përfshirë informacionin dhe këshillimin, lidhur me çdo mbikëqyrje shëndetësore së cilës ai duhet t'i nënshtrohet pas përfundimit të ekspozimit, dhe punëdhënësi:

a) rishikon vlerësimin e riskut;

b) rishikon masat e parashikuara për të eliminuar ose reduktuar riskun;



c) merr parasysh këshillën e profesionistit të kujdesit shëndetësor në punë për zbatimin e masave të parandalimit të ekspozimit apo të mbrojtjes personale, përfshirë mundësinë e caktimit të punëmarrësit në një punë alternative, ku nuk ka risk për ekspozim të mëtejshëm ndaj asbestit;

ç) siguron mbikëqyrje të vazhdueshme shëndetësore dhe merr masa për rishikimin e gjendjes shëndetësore të punëmarrësve të tjerë, që kanë qenë të ekspozuar në mënyrë të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë. Në raste të tilla, mjeku i punës apo profesionisti i kujdesit shëndetësor në punë propozon që personat e ekspozuar t'i nënshtrohen një ekzaminimi mjekësor.

VENDIM

Nr. 485, datë 29.6.2016

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. LUZHIANA ABAZAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Luzhiana Abazaj, në masën 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 487, datë 29.6.2016

PËR KLASIFIKIMIN E PRODUKTEVE BIOCID²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 95/2015, “Për shërbimet dhe produktet biocide”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat fizikë ose juridikë, që aplikojnë për autorizim për vendosjen në treg dhe për përdorimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Shqipërisë, klasifikojnë, etiketojnë dhe ambalazhojnë produktet biocide sipas përmbledhjes së karakteristikave të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet për rrezikun e kujdesit dhe me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 27, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe në vendimin që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve. Përmbledhja e karakteristikave të produktit biocid bëhet sipas legjislacionit për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide.

2. Sipas objektit të veprimit, produktet biocide klasifikohen në 22 tipa produktesh biocide, të grupuara në 4 fusha kryesore sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Një produkt biocid konsiderohet produkt biocid me rrezikshmëri të ulët nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të gjitha lëndët vepruese që përmbahen në produktin biocid i janë nënshtuar procesit të vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide;

² Ky vendim përaftron pjesërisht rregulloren (EC) nr. 528/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 22 maj 2012, lidhur me përdorimin dhe vendosjen në treg të produkteve biocide. CELEX32012R0528_EN_TXT OJ L 179/3, 11.07.2012, p. L 167/1 amenduar nga rregullorja nr. 334/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 11 marsit 2014.



b) produkti biocid nuk përmban asnjë lëndë që paraqet shqetësim;

c) produkti biocid nuk përmban nanomateriale;

ç) produkti biocid është mjaft efektiv;

d) manipulimi i produktit biocid dhe përdorimi i synuar i tij nuk kërkojnë pajisje mbrojtëse personale.

4. Produktet biocide që kanë në përbërjen e tyre agjentë biologjikë, që janë ose mund të jenë të rrezikshëm për njerëzit, klasifikohen në bazë të “Listës së agjentëve të klasifikuar në grupet 2, 3 dhe 4”, të përcaktuar në pjesën 2, të shtojcës III, të vendimit nr. 550, datë 27.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë””.

5. Ambalazhimi i produkteve biocide duhet të jetë i tillë që të mos lejojë ngatërrimin me ushqime apo pije. Nëse produktet biocide janë të disponueshme edhe për publikun e gjerë, ambalazhimi duhet të përmbajë elemente që dekurajojnë konsumin e tyre, dhe në mënyrë të veçantë, nuk duhet të jetë tërheqës për fëmijët.

6. Përmbajtja e etiketës nuk duhet të jetë çorientuese lidhur me risqet e produktit për shëndetin e njerëzve, kafshëve, mjedisit ose për efikasitetin e tij, dhe në asnjë rast, nuk duhet të shënohen në të indikacione “produkt biocid me risk të ulët”, “jotoksik”, “i padëmshëm”, “natyral”, “nuk dëmton mjedisin”, “i padëmshëm për kafshët” apo indikacione të ngjashme.

7. Çdo lëndë biocide duhet të jetë e pajisur me etiketën përkatëse në gjuhën shqipe. Në etiketë duhet të përmbahen në mënyrë të lexueshme, lehtësisht të kuptueshme dhe të pashlyeshme këto elemente:

a) emërtimi dhe përqendrimi i çdo lëndë aktive në sistem metrik;

b) nanoproduktet që mund të përmbahen, çdo risk specifik të lidhur me to dhe pas çdo reference për nanomaterialet vendoset fjala “nano” në thonjëza;

c) numri i autorizimit të produktit biocid, dhënë nga autoriteti kompetent;

ç) emri dhe adresa e mbajtësit të autorizimit;

d) tipi i formulimit;

dh) përdorimet për të cilat është autorizuar;

e) udhëzime për përdorimin, dozat dhe freku-

enca e aplikimit, shprehur në njësi metrike në mënyrë të kuptueshme për përdoruesin, për secilin përdorim për të cilin është dhënë autorizimi;

ë) të dhëna për efektet e mundshme anësore, direkte ose indirekte, udhëzime për ndihmën e parë;

f) nëse shoqërohet me fletë shpjeguese, vendoset fjalia “Përpara përdorimit lexoni instruksionet bashkëngjitur” dhe, aty ku aplikohet, të ketë paralajmërim për grupet vulnerabël;

g) udhëzime për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit të tij, përfshirë ndalimin e përdorimit të ambalazhit, kur kjo është e përshtatshme;

gj) numrin e lotit ose identifikuesin e produktit, sasinë neto, datën e prodhimit, datën e skadencës në kushte normale ruajtjeje;

h) kur është e aplikueshme, periudhën e kohës që nevojitet për efektin biocid, intervalin për t’u observuar midis aplikimeve të produktit biocid, ose midis aplikimit dhe përdorimit të produktit të trajtuar ose aksesit të njerëzve ose kafshëve në zonën ku janë përdorur produktet biocide, përfshirë anë të veçanta lidhur me mjetet dhe masat për dekontaminimin dhe kohëzgjatjen e nevojshme të ventilimit në zonat e trajtuara; të dhëna për pastrimin e mjaftueshëm të pajisjeve, të dhëna lidhur me masat mbrojtëse gjatë përdorimit të transportit;

i) ku është e aplikueshme, kategoritë e përdoruesve për të cilin produkti biocid është i kufizuar;

j) ku është e aplikueshme, informacion mbi ndonjë rrezik të veçantë për mjedisin, në veçanti për mbrojtjen e organizmave jotarget dhe shmangien e ndotjes së ujit;

k) produktet biocide që kanë në përbërjen e tyre agjentë biologjikë etiketohen duke përdorur shenjën “biohazard”, të paraqitur në shtojcën II, të vendimit nr. 550, datë 27.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë”” dhe të tjera shenja paralajmëruese përkatëse.

8. Nëse është e nevojshme, për shkak të funksionit të produktit biocid ose madhësisë së ambalazhit, informacionet që referohen në



shkronjat “d”, “e”, “ë”, “g”, “gj”, “h” dhe “j”, të pikës 7, të këtij vendimi, mund të jenë të shënuara mbi ambalazhim ose mbi një fletë shoqëruese, që është pjesë përbërëse e ambalazhimit.

9. Autoriteti kompetent përcakton modelin apo draftin e ambalazhimit, etiketës dhe fletës shoqëruese.

10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

SHTOJCA I

Numri	Tipi i produktit	Përshkrimi
Grupi kryesor 1. Dezinfektantët		
Këto lloje produktesh nuk përfshijnë produktet e pastrimit të cilat nuk kanë për qëllim që të kenë një efekt biocid, duke përfshirë lëngjet pastruese, detergjentet dhe produkte të ngjashme.		
PT 1	Higjiena e njeriut	Produktet në këtë grup janë produkte biocide që përdoren për nevojat e higjienës njerëzore, të zbatuara në ose në kontakt me lëkurën e njeriut me qëllim kryesor dezinfektimin e lëkurës.
PT 2	Dezinfektantë dhe algicide për t'u përdorur jo direkt te njerëzit dhe kafshët	Përdoret për dezinfektimin e sipërfaqeve, materialeve, pajisjeve dhe mobileve, të cilat nuk përdoren në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimet ose pajisjet për përgatitjen e tyre. Fushat e përdorimit përfshijnë, ndër të tjera, pishina, akuariume, banjagj dhe ujëra të tjera; sistemet e ajrit të kondicionuar, muret dhe dyshemetë në vendet private, publike dhe industriale, si dhe në fusha të tjera të aktiviteteve profesionale. Përdoret për dezinfektim e ajrit, të ujit që nuk përdoret për konsum njerëzor apo të kafshëve, tualete kimike, ujërave të zeza, mbeturinave spitalore dhe tokës. Përdoret si algicid për trajtimin e pishinave, akuariumeve dhe ujërave të tjera, si dhe për materialet e konsumit të trajtimeve mjekësore. Përdoret për të përfshirë në tekstile, pëlhura, maska, ngjyra dhe artikuj të tjerë ose për materiale me qëllim prodhimin e artikujve trajtues me veti dezinfektuese.
PT 3	Higjiena veterinare	Përdoren për nevojat e higjienës veterinare, të tilla si: dezinfektues, sapunë dezinfektues, produkte të higjienës orale ose trupore, ose me funksion antimikrobial. Përdoret për të dezinfektuar materialet dhe sipërfaqet që lidhen me strehimin ose transportin e kafshëve.
PT 4	Ushqimet dhe zonat e ushqimeve	Përdoret për dezinfektimin e pajisjeve, kontejnerëve, enëve të kuzhinës për konsumim, sipërfaqet apo gypat e lidhur me prodhimin, transportin, magazinimin ose konsumimin e ushqimit ose artikujve ushqimorë (duke përfshirë ujin e pijshëm) për njerëzit dhe kafshët. Përdoret për të mbushur materiale që mund të hyjnë në kontakt me ushqimin.
PT 5	Uji i pijshëm	Përdoren për dezinfektimin e ujit të pijshëm për njerëzit dhe për kafshët.



Numri	Tipi i produktit	Përshkrimi
Grupi kryesor 2. Konservuesit/ruajtësit		
Këta tipa produktesh përfshijnë vetëm produkte për të parandaluar zhvillimin mikrobial dhe të algave.		
PT 6	Konservuesit për produktet gjatë ruajtjes	Përdoren për ruajtjen e produkteve të prodhuara, përveç ushqimeve, ushqimeve të kafshëve, kozmetikëve ose produkteve mjekësore apo pajisjeve mjekësore duke i mbrojtur prej ndotjes dhe prishjes mikrobike. Përdoret si konservues për ruajtjen ose përdorimin e rodenticideve, insekticideve ose karremave të tjerë.
PT 7	Konservuesit e filmave	Përdoret për ruajtjen e sipërfaqeve ose shtresave të holla dhe veshjeve të ndryshme nga ndotja dhe prishja mikrobike ose nga rritja e algave për të mbrojtur karakteristikat potenciale të sipërfaqes së materialeve apo objekteve, të tilla si: ngjyra, plastikës, ngjitësve, ngjitësve të mureve, lidhësit, gazetave, veprat e artit etj.
PT 8	Konservuesit e drurit	Përdoret për ruajtjen e drurit duke përfshirë edhe fazën e përpunuar të tij në sharra ose të produkteve të drurit, nga organizmat që shkatërrojnë drurin ose që e shformojnë atë, duke përfshirë insektet. Ky lloj produkt përfshin njëkohësisht produktet parandaluese dhe kurative.
PT 9	Konservuesit e fibrave, lëkurës, gomës dhe materialeve të polimerizura	Përdoret për ruajtjen e materialeve fibroze ose të polimeri-zuara, të tilla si lëkurë, goma apo letra ose produkte tekstile, prej prishjes mikrobike. Ky tip produkti përfshin produktet biocide të cilat janë armiqtë për kolonitë dhe vendstrehimet e mikroorganizmave në sipërfaqen e materialeve dhe për këtë arsye pengojnë ose parandalojnë zhvillimin e erërave të ndryshme të pakëndshme, por sigurojnë edhe përfitime të tjera.
PT 10	Konservuesit e materialeve të ndërtimit	Përdoret për ruajtjen e masonerisë, materialeve të përbërë apo materiale të tjera të ndërtimit, përveç drurit, nga sulmet mikrobike dhe algave.
PT 11	Konservuesit e sistemeve të lëngjeve ftohëse dhe të përpunimit	Përdoret për ruajtjen e ujit ose lëngjeve të tjera të përdorura në ftohjes dhe përpunimit të sistemeve, nga organizmat e dëmshëm, siç janë: mikrobet, algat dhe midhjet. Produktet që përdoren për dezinfektim të ujit të pijshëm ose ujit për pishina nuk janë të përfshira në këtë tip produkti.
PT 12	Slimicidet, kimikatet që parandalojnë zhvillimin e papastërtive	Përdoren për parandalimin ose kontrollin e rritjes së papastërtive në materiale, pajisje dhe struktura të përdorura në proceset industriale, p.sh. në industrinë e drurit dhe letërës, si dhe në shtresat e depërtueshme zallore në nxjerrjen e naftës.
PT 13	Konservuesit e lëngjeve punuese dhe prerëse	Produkte për të kontrolluar shkatërrimin mikrobial në lëngjet që përdoren në përpunimin dhe prerjen e metaleve, xhamit ose të materialeve të tjera.



Numri	Tipi i produktit	Përshkrimi
Grupi kryesor 3. Kontrolli i dëmtuesve		
PT 14	Rodenticidët	Përdoren në kontrollin e minjve të shtëpisë, minjve të kanaleve dhe brejtësve të tjerë më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.
PT 15	Avicidet	Përdoren për kontrollin e shpendëve, zogjve më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.
PT 16	Moluskicidet, vermucidet dhe produktet për kontrollin e invertebro-rëve të tjerë	Përdoren për kontrollin e kërmijve dhe molusqeve të tjera, krimbave të ndryshëm dhe invertebrorë të tjerë, që nuk kontrollohen nga tipa të tjerë produktesh më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.
PT 17	Pishicidet	Përdoren për kontrollin e peshqve më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.
PT 18	Insekticidet, akaricidet dhe produktet për kontrollin e artropodëve të tjerë	Përdoren për kontrollin e artropodëve (p.sh., insekteve, araknidëve ose merimangave dhe akrepave dhe krustacetë ose gaforret), më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.
PT 19	Repellentët dhe atraktantët	Përdoren për kontrollin e organizmave të dëmshëm (jovertebrorë, si: pleshtat, kurrizorët, siç janë: zogjtë, peshqit, brejtësit), duke i zmbarsur ose duke i tërhequr, duke përfshirë edhe ata që përdoren për higjienën e njeriut dhe kafshëve direkt në lëkurë apo indirekt në mjedisin e njerëzve apo kafshëve.
PT 20	Kontrolli i vertebrorëve të tjerë	Përdoren për kontrollin e vertebrorëve përveç atyre që kontrollohet me tipa të tjerë produktesh të këtij grupimi kryesor, më tepër se sa dëbimi dhe tërheqja e tyre.

Numri	Tipi i produktit	Përshkrimi
Grupi kryesor 4. Produkte të tjera biocide		
PT 21	Produktet kundër ndotjes	Përdoren për kontrollin e rritjes dhe kolonizimin e organizmave ndotës (mikrobet dhe formave të larta të disa lloje bimësh dhe kafshësh), në mjetet lundruese, lundrat, pajisjet e akuakulturës ose të strukturave të tjera që përdoren në ujë.
PT 22	Lëngjet balsamosëse dhe balsamosësve të kafshëve	Përdoren për dezinfektimin dhe ruajtjen e trupave të kafshëve dhe njerëzve ose pjesë të tyre.

VENDIM

Nr. 491, datë 29.6.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “LEZHË–SHËNGJIN” (SHTESA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen

në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lezhë–Shëngjin” (shtesa).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.



3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “arë”, me shumën 705 990 (shtatëqind e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë, nga të cilat:

- truall, me sipërfaqe 176 m², me vlerë 604 560 (gjashtëqind e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë;

- arë, me sipërfaqe 230 m², me vlerë 101 430 (njëqind e një mijë e katërqind e tridhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “truall” dhe “arë”, prej 705 990 (shtatëqind e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR “LEZHË-SHËNGJIN” (SHTESA)

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi për njësi	Vlera (lekë)	Shënime
1	Bashkëpronarët Çetaj+Martini			3126	5//41	Truall	176	3435	604560	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Prek	Gjeto	Gjeloshi	1987	12/14//1	Arë	230	441	101430	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHUMA						406		705990	

Ndreqje gabimi

Në vendimin nr. 399, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të Faqe|8436

gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 99, viti 2016, f. 5589, bëhet ndreqja e gabimit material, konkretisht, në pikën 3, shkronja “a”, nënndarja “i”, shprehja “... 50% pambuk ...” bëhet “... 50% lesh ...”.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë